VENDIM
Nr.894, datë 19.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS NDROQ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ndroq të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ndroq të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.478, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ndroq të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ndroq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ndroq Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
2,3	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
4-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
13-25	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
26,37	Varreza publike	Në pronësi
38-50	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën ekonomike.	Në pronësi
176-286,331-425	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
309,311,313,315,317, 319, 321, 323, 325,327,329	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
310,314,316,318, 320,322, 324,326,328,330	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
426	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-	Në pronësi

	kanalizimeve	